

V E N D I M
Nr.289 datë 14.6.1993

PËR TARIFAT E UJITJES

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Tarifat e ujitjes për vitin 1993 të jenë:

- Për zonat fushore (me pjerrësi deri 5%).....1,4 lekë/m³
- Për zonat kodrinore-malore (me pjerrësi mbi 5%).....1,0 lekë/m³
- Për orizin.....960 lekë/m³

2. Tarifat e dhënies së ujit për ndërmarrjet e përbashkëta bujqësore, si dhe për të gjitha ndërmarrjet e tjera që përdorin ujin për nevoja teknologjike, të jenë sipas kostos faktike (duke përfshirë 10 për qind rentabilitet, por jo më shumë se 8 lekë/m³).

3. Diferenca e shpenzimeve prej 400 milionë lekësh të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 1993.

4. Ndarja e zonave fushore dhe kodrinore e malore të bëhet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, duke u mbështetur në propozimet e këshillave të rretheve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi